

HULUMTIM- DIVORCET FORMALE NË MAQEDONI

MARTESAT PËR "LETRA" KURBETI



Shkurrorëzimet te shqiptarët e Maqedonisë, apo martesat siç thuhet në popull, për "letra" kurbeti, shënojnë një rritje të vazhdueshme. Hulumtimi tregoi edhe për situata kur njerëzit depërtojnë ilegalisht në vendet evropiane, kryesisht në Gjermani, ku edhe punojnë punë krahu. Mënyra tjetër dhe më e përdorshme, "është gjetja e një shtetase të huaj që do të pranojë të martohet vetëm për t'i marrë letrat". Por në fakt, cila janë arsyt e vonësve me vizat, dikush tre vjet, e dikush madje të tërhiqet nga insistimi për të marrë vizën, dhe së fundmi, "t'i gjejë çare tjetër vetes"

FAMI BAJRAMI

Ka që tre vjet që pres vizë për të shkuar në Gjermani. Shpresat për të marrë leje për të ikur në perëndim, tanimë janë fikur. Kjo flet në faktin se jam tërhequr nga institimi për t'u pajisur me vizë, pasi që edhe shtetasja gjermane më të cilën vura kurrorë dikur, u tërhoq.

Kështu e fillon ndodhinë, personi A.A. nga një fshat i Shkupit, i cili tanimë fatin e tij ka drejtuar në Kroaci për punë sezonale. Rasti i këtij personi nuk është i vetmi që përfshinë mozaikun e këtij fenomeni, pasi që ka edhe të tjerë që kanë fatin e tij. Rrugën që ka ndjekur ky shqiptar është vetëm një formë,

madje për të ardhur deri te dokumentat nëpërmjet martesës me shtetase të huaj. Hulumtimi, tregoi se një pjesë tjetër arrijnë të depërtojnë edhe ilegalisht në vendet evropiane, kryesisht në Gjermani, por nëpërmjet ambasadave tjera, ku edhe punojnë punë krahu. Ndërkohë, ata kërkojnë të gjejnë ndonjë grua gjermane për të bërë letrat dhe aktojnë, "kinse kanë rënë në dashuri me të".

"Sherri" me shtetaset e huaja

Pasi të vendosin të martohen, ata kthehen bashkë në Maqedoni ku vënë kurrorën, pasi paraprakisht ta ketë prishur kurrorën me gruan e parë. Më

pas, bashkë shkojnë në vendin e caktuar evropian dhe bashkëtojnë, deri kur personi ligjërisht të plotësojë kushtet për marrje të lejes së qëndrimit.

Mënyra tjetër dhe më e përdorshme, është gjetja e një shtetase të huaj që do të pranojë të martohet vetëm për t'i marrë letrat. Për këtë shërbim ajo merr para të majme nga "bashkëshorti" i saj nga Maqedonia dhe nuk bashkëton me atë. Në Gjermani, madje mendohet se ka Agjencione të shumta të cilat ndërmjetësojnë për gjoja "bashkim zemrash". Pjesa dërmuese e vajzave që lajmërohen në Agjenci për të kërkuar burra nga vendet e treta janë nga Gjermania Lindore dhe një gjë të këtillë mendohet ta bëjnë për para. Madje, për të ardhur deri te viza, pasi që t'i dorëzoni të gjitha dokumentet e nevojshme, në intervistat e caktuara në disa Ambasada, do t'u pyesin se sa kurrorëzime dhe sa fëmijë keni pasur, dhe çfarë nacionaliteti kanë qenë gjyshi apo gjyshja e juaj etj.

Personi tjetër, që pranon të prononcohet me iniciale, SH.V, pohon të njëjtën. Pra, ka disa vjet që pret vizë, ndërsa edhe sot e kësaj dite thotë se ka humbur shpresat.

"Unë pagova disa mijëra euro në shërbim të shtetasës së huaj. Kisha shpresë, që viza të përshpejtohet, por edhe më tej ka vonesa. Disa herë kam qëndruar atje, pa status të rregullt. Tani jam i papunë dhe nuk di ka t'ia mbajë. Thënë shkurt, i kam humbur shpresat", thotë SH.D.

Kokëçarjet me vizat

"Këtë muaj mbushi tre vjet që jam në vendlindje. Vura kurrorë në fshatin tim të lindjes me shtetase gjermane. Shpresova se do të pajisem së shpejti me vizë, por u bënë vite. Nuk është pak, tre vjet të tërra", thotë personi tjetër, S.B. nga një fshat i Tetovës.

Ai pohon se shtetasja gjermane me të cilën ka vu kurrorë nuk tërhiqet nga insistimi për të marrë vizë, ndërsa ajo edhe nga atje bën presione që ky person të pajiset me vizë.

"Unë edhe disa herë, bashkë me të, kemi qenë në ambasadën gjermane në Shkup. Na kanë thënë se do t'u rjoftojmë me kohë për ardhjen e vizës", thotë më tej personi S.B.

Ai madje pohon se ka angazhuar avokat në Gjermani me qëllim të përshpejtimt të procedurës për marrjen e vizës.

Fat identik është edhe për personin N.M. i cili që 16 muaj thotë se është në pritje të vizës.

"Nuk mund t'i kuptoj këto vonesa. Unë as që jam i martuar këtu në Maqedoni. Kam 22 vjet. Vura kurrorë në Shkup dhe jam në pritje. Kam angazhuar edhe avokat në Gjermani, ndërsa edhe e dashura ime, shtetase gjermane insiston që viza të arrijë pa vonesa të mëtejme", thotë N.M.

Ndërkaq, shumë nga personat të cilët janë në pritje të vizës janë të habitur me procedurat që kërkohen nga Ambasadat. Shumë nga ata kanë parë zgjidhje duke nxjerrë vizë në ndonjë ambasadat tjera në Shkup, dhe më pas për t'u drejtuar në vendet e dëshiruara të shteteve të Perëndimit.

Disa nga ata pohojnë për persona të caktuar që dërgojnë Ambasadat nëpër vendet ku shumica e personave janë në pritje të vizave për të marrë të dhëna nga ofiqarët ku kanë vu kurrorën.

"Bile, ata intersohen në hollësi për statutin tonë. Nëse jemi të martuar me shtetase vendore, nëse kemi fëmijë dhe të tjera", thotë personi S.B. nga Shkupi. (vazhdon)

(Hulumtimi është përkrahur nga Asociacioni danez për gazetari hulumtuese SCOOP, që vepron edhe në Maqedoni)



FERIÇKOVSKI I JEP GODITJE GRUEVSKIT

Beteja për emrin nuk bëhet në rrugicat ballkanike

Me moton "Maqedonia e Integruar dhe e Sigurtë", Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM), ka promovuar të hënën Shtabin zgjedhor si dhe ka paralajmëruar mbajtjen e tubimit të parë në Prilep, duke nisur kështu fushatën e zgjedhjeve lokale dhe presidenciale që do të mbahen me 22 mars.

Kandidati për presidet i LSDM-së Lubomir Feriçkovski gjatë prezantimit të Shtabit zgjedhor ka thënë se do t'i kundërvihet politikës aktuale të kryeministrit Nikolla Gruevski. Kjo sipas tij, shpie drejt izolimit dhe ngecje në rrugën drejt integritit në Bashkimin Evropian dhe NATO.

Sipas Feriçkovskit, "beteja për emrin dhe identitetin maqedonas duhet të zhvillohet në botë dhe jo nëpër rrugicat ballkanike me përplot nacionalizma".

"Sepse të paktën këtë traditë elementare në Maqedoni e kemi pasur dhe kemi pasur shansin të mësojmë nga presidenti i parë Kiro Gligorov si dhe nga Boris Trajkovski dhe atje zhvillohet beteja e vërtetë për identitetin maqedonas", tha ai.

"Neve do të mund të na bregos fakti, jo se ndonjëher fëmijët tanë janë të ashpër ndaj identitetit tonë ose prapë e komentojnë, por neve njëmendët mund të na bregosë fakti kur ne si shtet do ti humbim pozicionet në Uashington dhe Bruksel, kur do ti humbin pozicionet nëpër të gjitha qendrat e diplomacisë", tha Feriçkovski.

KANDIDATJA E PLD-SË NAJÇESVKA

Premton partneritet me qytetarët

Kandidatja e partisë liberaldemokrate (PLD) për kryetar të qytetit të Shkupit, Mirjana Najčevska, pohoi se programi i saj për kryeqytetin ofron projekte konkrete për zgjidhjen e problemeve me të cilat përballlet ai. "Ne dëshirojmë të ndërtojmë qytet të qëndrueshëm, ai është qytet në të cilin mbrojtja e ambientit jetësor, çështjet sociale dhe ekonomike janë të lidhura. Ai është qytet në të cilin të gjitha zgjidhjet arrihen me partneritet mes qytetarëve, mes pushtetit lokal dhe atij qëndror", tha Najčevska. Ajo shtoi se dëshiron të zgjoj një institucion të harrura, e ajo është referendumi i qytetarëve.

BOCEVSKI NË PRAGË

I nevojshëm zgjerimi në BE

Koha e krizës, rekomandoi Bocevski, kërkon vendime inkurajuese dhe liderë inkurajues si në nivelin kombëtar edhe në atë evropian

Zgjerimi është politika më pozitive e BE-së, por Maqedonisë dhe të gjitha vendeve të tjera nga Ballkani Perëndimor momentalisht i nevojitet qartësi dhe parashikueshmëri për tërë procesin si dhe vendosjen në kornizë të saktë kohore, siç ishte bërë me shtetet që hynë në BE në vitin 2004, respektivisht në vitin 2007, theksoi zëvendëskryeministri Ivica Bocevski në debatin e tij në konferencën e të hënës, "BE zgjerim-pesë vjet pas kësaj", në Pragë.

Koha e krizës, rekomandoi Bocevski, kërkon vendime inkurajuese dhe liderë inkurajues si në nivelin kombëtar edhe në atë evropian.

"Konsideroj se ka arritur pjekuria për një plan të përgjithshëm dhe të madh që do ta parashikojë jo vetëm fazën vijuese por të gjithë procesin

deri në integrimin përfundimtar të çdo vendi nga Ballkani Perëndimor, proces me plane të qarta dhe korniza kohore për çdo shtet, deklaroi Bocevski pas përfundimit të panel debatit.

Pjesëmarrësit në konferencë, shtoi Bocevski edhe një herë konfirmuan se zgjerimi është politika më e suksesshme e BE-së. Unik është konkluzioni se nga kjo dobi të madhe kanë edhe anëtarët e debi edhe ato të vjetra si nga aspekti ekonomik, financiar, politik, kulturor, diplomatik....

"Edhe kryetari i Komisionit evropian Baroso e ripërtëriti frymën e politikës të zgjerimit që BE-ja e ka jetësuar në dekadat e kaluara" theksoi nënkryeministri. Madje, në fokusin e konferencës që e organizojnë kryesia çeke dhe Komisioni Evropian me rastin e pesëvjetorit të zgjerimit më të



madhe të BE-së, janë efektet ekonomike nga hyrja e anëtarëve të reja. Marrin pjesë rreth 50 eurodeputetë të lartë. U debatua edhe për arritjet ekonomike si dhe për stabilitetin makrofinanciar. Konferencën e hapi kryeministri çek Mirek Topolaneck ndërsa fjalim pati edhe kryetari i Komisionit Evropian Zhoze Manuel Baroso.

Në marginat e tubimit nënkryeministri Ivica Bocevski do të ketë edhe takime bilaterale me ministria për çështjet evropiane nga disa vende evropiane. Ai do t'i informojë për prioritetet e qeverisë maqedonase lidhur me eurointegrimet.

Greqia dënon incidentin

Ministria e Jashtme e Greqisë, përmes një deklarate të zëdhënësit të saj Jorgos Kumucakos, ka dënuar incidentin e të dielës në Ohër.

"Ngjarjet e këtilla, të cilat për fat keq ndikojnë negativisht në komunikimin midis popujve, janë rezultat i dukshëm i nacionalizmit dhe mungesës së tolerancës kundër Greqisë, e cila me vetëdije kohëve të fundit nxitet në Shkup", thuhet në deklaratën e zëdhënësit grek Jorgos Kumucakos. Ministria e Jashtme greke u ka bërë thirrje autoriteteve të IRJM-së, t'i mbrojnë qytetarët grekë që vizitojnë këtë vend si dhe t'i zbulojë dhe dënojnë fajtorët e incidentit të së dielës mbrëma.